



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 290/8 prot.

Datë 12.03.2025

V E N D I M
Nr. 356/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur -punë*”, me Nr. REF-32450-12-10- 2024, me objekt “*Rikualifikim urban i pallateve në hyrje të Selenicës*”, me fond limit 50,390,955.29 lekë (pesëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë njëzet e nëntë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “C O L O M B O” SHPK, me NUIS J82916489E, me adresë: Fier, Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Selenicë, me adresë: Rruga ‘Llambi Bombaj’, Selenicë.

Subjekte të Interesuara:

BOE “SARDO” SHPK (përfaqësues), me NUIS K13120402Ë, me adresë: Fier, Lagjja Apollonia, Rruga Jakov Mile, Z. Kadastrale 8534, Nr. Pasurisë 3/5 -N12 & “LIQENI VII” SHPK.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.12.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur -punë*”, me Nr. REF-32450-12-10- 2024, me objekt “*Rikualifikim urban i pallateve në hyrje të Selenicës*”, me fond limit 50,390,955.29 lekë (pesëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë njëzet e nëntë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

II.2. Në datën 30.12.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 16.01.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “SARDO” shpk me & “LIQENI VII” shpk, vlera 42,799,999.94 lekë pa tvsh
2. OE "COLOMBO" sh.p.k. vlera 46,920,006 leke pa tvsh

II.4. Në datën 24.01.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 05, datë 27.01.2025, ku është shpallur fitues BOE “SARDO” shpk me & “LIQENI VII” shpk.

II.5. Në datën 29.01.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 290/2025 protokoli, me datë 29.01.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5014 e operatorit ekonomik “C O L O M B O” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar. Komisioni i Prokurimit Publik publikoi kriteret që operatori ekonomik “COLOMBO” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit, të parashtruara në ankesën me nr. 290 prot., datë 29.01.2025.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 290/1 prot., datë 30.01.2025, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “COLOMBO” SHPK, që ka parashtruar me anë të ankesës me nr. 290/2025 prot., datë 29.01.2025.

II.7. Më datë 03.02.2025, operatori ekonomik “SARDO” SHPK ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave, nëpërmjet shërbimit postar, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 290/2 prot., datë 03.02.2025.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 231/2 prot., datë 13.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 290/3 prot., datë 18.02.2025, me objekt “Përcjellje vendimi” dërguar me shërbim postar, nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues (Vendimi me datë me nr. 231/1 prot., datë 13.02.2025), ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.9. Me shkresën nr. 209/4 prot., datë 01.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik, i ka kërkuar autoritetit kontraktor, Bashkisë Selenicë, që të dorëzojë pranë institucionit tonë mostrat e paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, së bashku me dokumentacionin shoqërues, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre.

II.10. Me shkresën nr. 541/1 prot., datë 05.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 290/5 prot., datë 10.03.2025, me objekt “Kthim përgjigje”, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion në lidhje me shkresën me nr. 290/4 prot., datë 01.03.2025.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, kanë dorëzuar argumente në formë shkresore.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “COLOMBO” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, me arsyen se: *“.....Pretendojmë se shoqëria “Lqeni VII” SHPK ka paraqitur të njëjtat punë të ngjashme në të cilat AK nuk ka verifikuar në mënyrë korrekte plotësimin e pikës 2.3.1/a dhe b sipas DST. Pretendimet tona i bazojmë edhe në fakte reale pasi nga verifikimi në faqen openprocurement.al shohim se punët e ngjashme të këtij operatori kryesisht janë të karakterit infrastrukturor (rrugë, linja tensioni si dhe ujësjellësa)......”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3 “Kapaciteti teknik”, i dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e

vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

a. Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:

- Formulari i vlerësimit
- Kontratë punimesh;
- Situacion përfundimtar;
- Akt-kolaudimi;
- Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b. Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:

- Formulari i vlerësimit
- Kontratën e punimeve,
- situacionin përfundimtar,
- aktin e kolaudimit, (në rastet kur ky dokumentacion leshohet)
- Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- faturën tatimore të Situacionit përfundimtar **të deklaruara në organet tatimore**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratë baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

Akt Marrëveshje Bashkëpunimi e lidhur më datë 30.12.2024, midis operatorëve ekonomikë “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK. Palët pjesëmarrëse në këtë akt-marrëveshje, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendim Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Dokumentave të Tenderit të hartuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Selenice, me objektet “Rikualifikim urban i

pallateve në hyrje të Selenicës” me fond limit : 50,390,955.29 lekë (pesëdhjet milion e treqind e nentëdhjet mijë e nentëqind e pesëdhjet e pese pike njezet e nente) Lekë Pa TVSH duke shprehur vullnetin e tyre të lire deklaruan se janë dakort të bëjnë bashkimin e përkohshëm të Operatorëve Ekonomike të lartëpërmendur. Palët kanë rënë dakort që detyrat për realizimin e objektit të mësipërm si dhe ndarja e punimeve sipas pjesëmarrjes do të jetë:

- Operatori ekonomik “SARDO” SH.P.K, në masën 40% me vlere XXXXX tvsh
- Operatori ekonomik “LIQENI VII” SH.P.K, në masën 60% me vlere XXXX me tvsh
- Totali 100 % me vlere XXXX me tvsh

Ndarja e cdo zeri pune do te jete sipas preventivit bashkelidhur kesaj akt-marreveshje.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK, ka dorëzuar në SPE:

1. Kontratë me objekt “Ndërtim i rrugës Jusuf Gërvalla” Bashkia Tiranë”, e lidhur ndërmjet autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë dhe subjektit “LIQENI VII” SHPK më datë 26.10.2020, me vlerë XXXX lekë me TVSH, shoqëruar me Formulari i vlerësimit; Kontratë punimesh; Situacion përfundimtar; Akt-kolaudimi; Çertifikaten e marrjes ne dorezim, Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim, Fatura Tatimore.
2. Kontratë me objekt “Punime rindërtimi në rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallatet), Qyteti Reps” Bashkia Mirëditë”, e lidhur ndërmjet autoriteti kontraktor Bashkia Mirëditë dhe BOE “LIQENI VII” SHPK (50.1%) & “Kthella” SHPK (49.9 %) më datë 28.02.2022, me vlerë XXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me Formulari i vlerësimit; Kontratë punimesh; Situacion përfundimtar; Akt-kolaudimi; Çertifikaten e marrjes ne dorezim, Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim, Fatura Tatimore.
3. Kontratë me objekt “Rikonstruksioni i hapsirave publike në bllokun e banimit në Lagjen Nr. 17 dhe tek Mueu i Dëshmorëve” Bashkia Durrës”, e lidhur ndërmjet autoriteti kontraktor Bashkia Durrës dhe BOE “LIQENI VII” SHPK (50.1%) & “Kthella” SHPK (49.9 %) më datë 02.09.2022, me vlerë XXXXX lekë me TVSH, shoqëruar me Formulari i vlerësimit; Kontratë punimesh; Situacion përfundimtar; Akt-kolaudimi; Çertifikaten e marrjes ne dorezim, Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim, Fatura Tatimore.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “SARDO” SHPK, ka dorëzuar në SPE:

1. Kontratë me objekt “Rikonstruksion i Cerdhes Patos me hapësirat përreth” Bashkia Patos”, e lidhur ndërmjet autoriteti kontraktor Bashkia Patos dhe subjektit “SARDO” SHPK më datë 19.01.2023, me vlerë XXXXXX lekë me TVSH, shoqëruar me Formulari i vlerësimit; Kontratë punimesh; Situacion përfundimtar; Akt-kolaudimi; Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim, Fatura Tatimore.
2. Kontratë me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Vjetër Dega Dogana Vlorë”, e lidhur ndërmjet autoriteti kontraktor Dega e Doganës Vlorë dhe BOE “SARDO” SHPK (95%) & “ZDRAVO” SHPK (3 %) & “KMK” SHPK (2%), më datë 04.08.2020, me vlerë XXXXX lekë me TVSH, shoqëruar me Formulari i vlerësimit; Kontratë punimesh; Situacion përfundimtar; Akt-kolaudimi; Çertifikaten e marrjes ne dorezim, Çertifikatën

e Përkohshme të marrjes në dorezim, Fatura Tatimore.

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.4. Në nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore

dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

Në nenin 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, referuar edhe pikës 3, të nenit 88 të VKM nr.285, më datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **Kur**

oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, Komisioni konstaton se referuar kontratës së bashkëpunimit më datë 30.12.2024, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku *Palët kanë rënë dakort që detyrat për realizimin e objektit të mësipërm si dhe ndarja e punimeve sipas pjesëmarrjes do të jetë:*

- *Operatori ekonomik “SARDO” SH.P.K, në masën 40% me vlere XXXX tvsh*
- *Operatori ekonomik “LIQENI VII” SH.P.K, në masën 60% me vlere XXXX me tvsh*
- *Totali 100 % me vlere XXXXXX me tvsh*

Ndarja e cdo zeri pune do te jete sipas preventivit bashkelidhur kesaj akt-marreveshje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky bashkim operatorësh ekonomik i krijuar me kontratën e bashkëpunimit të datës 30.12.2024, ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi, ku përfaqësues i këtij bashkimi rezulton të jetë shoqëria “SARDO” SHPK. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.2.

Nga krahasimi i kontratave të dorëzuara nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara, të realizuara nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionit të specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomike ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës apo dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga

bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre).

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike, ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, me një vlerë jo më të madhe se 50 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës pesë vjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga anëtari i BOE me % më të lartë të pjesëmarrjes me 60% (sipas % së pjesëmarrjes), konkretisht nga operatori ekonomik *“LIQENI VII”* SHPK, Komisioni konstaton se, ky i fundit e përmbush kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor për të paraqitur dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kështu që rrjedhimisht KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga anëtari i BOE, operatori ekonomik *“LIQENI VII”* SHPK për plotësimin e kushtit të parë *“punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Liqeni VII*” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1/b të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim këtë kontratë:

1-. Kontratë me objekt “Punime rindërtimi në rikonstrukcion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallatet), Qyteti Reps” Bashkia Mirëditë”, e lidhur ndërmjet autoriteti kontraktor Bashkia Mirëditë dhe BOE “LIQENI VII” SHPK (50.1%) & “Kthella” SHPK (49.9 %) më datë 28.02.2022, me vlerë XXXXXX lekë pa TVSH, shoqëruar me Formulari i vlerësimit; Kontratë punimesh; Situacion përfundimtar; Akt-kolaudimi; Çertifikaten e marrjes në dorezim, Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim, Fatura Tatimore. (në rastin konkreti BOE “LIQENI VII” SHPK (50.1%) & “Kthella” SHPK (49.9 %) kemi: $50.1\% * XXXXXX = XXXXX$ lekë pa Tvsh).

Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratën e sipërcituar, pasi kjo kontratë i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brenda afatit pesë vjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni i Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratën e sipërcituar, e cila i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga përlllogaritja e kontratave, situacionet dhe faturat e paraqitura nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK, rezulton se është në vlerën XXXXXX lekë pa Tvsh, në raport me % e pjesëmarrjes (50.1%), sipas kontratës së bashkëpunimit ndërmjet BOE, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet *1-)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*, për të cilën ky operator ka paraqitur një kontratë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit, nga operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK për një kontratë jo më pak se 40 % e F.L = $50,390,955.29 \text{ FL} * 40\% = 20.156.382.1$ lekë. Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratat e ngjashme të marra në shqyrtim rezulton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” SHPK, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në secilën prej kontratave të paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik rezulton se janë në vlerën XXXXX lekë pa TVSH, duke arritur dhe tejkaluar vlerën prej 20.156.382.1 lekë pa TVSH që duhet të plotësonte ky operator në varësi të përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit midis BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, duke e përmbushur kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë*

viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK. Sa më lart, nga verifikimi i punëve të realizuara dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, të paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik ” LIQENI VII” SHPK ka kryer vlerën e kërkuar të punimeve të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Nga verifikimi i zërave dhe volumeve të ngjashme të preventivit të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si eksperiencia të ngjashme të mëparshme, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërimit/përshkrimit, me zërat e preventivit të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK ka arritur të dëshmojë se ka në vlerën e kërkuar, kryerjen e punëve të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi zërat e konsideruar të ngjashëm përmbushin dhe e arrijnë vlerën jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose 20.156.382.1 lekë pa TVSH, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik "LIQENI VII" SHPK vërteton se plotëson kriterin 2.3.1/a të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues COLOMBO SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “COLOMBO” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK me arsye se: “Pretendjmë se nga BOE “SARDO” SPK & “LIQENI VII” SHPK nuk janë paraqitur për dorëzimin e mostrave si është bërë kualifikimi i tyre, kur vetë AK NË DST ka përcaktuar shprehimisht se: Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s’kualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.9. “Kriteret e veçanta të kualifikimit” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.9 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor një mostër për:

- Pllaka trotuari
- Kabell elektrike
- Katerma per izolimin

* Mostrat e paraqitura duhet të jenë prerje ku të evidentohen të gjitha elementet, detajet dhe aksesoret sipas specifikimeve teknike.

- **Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s’kualifikim.**

III.2.2. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të

këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.3. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në

dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.5. Në nenin 40, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.2.6. Udhëzimit nr. 03, datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” pika 3 parashikon se: *“Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi. Në këtë kuptim, në rast kur autoriteti/enti kontraktor vlerëson si të nevojshëm dorëzimin e mostrave, në datën dhe orën e përcaktuar në dokumentet e tenderit për paraqitjen e tyre nga ofertuesit, duhet të mbajë një procesverbal,. Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara. Në këtë rast, mbajtja e procesverbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave, deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit. Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët (përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet t’i vihet në dispozicion ofertuesit/ve. Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur”.*

III.2.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të

refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.8. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kushtin që Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor **një mostër për:** Pllaka trotuari; Kabell elektrike; Katerma për izolimin.

** Mostrat e paraqitura duhet të jenë prerje ku të evidentohen të gjitha elementet, detajet dhe aksesoret sipas specifikimeve teknike. Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s'kualifikim”.*

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të depozituar në KPP nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën nr. 541/1 prot., datë 05.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 290/5 prot., datë 10.03.2025, me objekt “Kthim përgjigje”, rezulton se, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal administrimi të mostrave ,ku konstatohet e pohuar nga autoriteti kontraktor se BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK nuk ka paraqitur në orën për dorëzimin e mostrave, sic parashikohet në dokumentat e tenderit, pasi në gjykimin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Oferta edhe nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, të cituar në informacionin e dërguar prej tyre në KPP, *BOE e ka përmbushur kriterin në lidhje me paraqitjen e mostrave pasi procedura është zhvilluar në formë elektronike ku në SPE janë ngarkuar katalogët e kërkuar dhe nuk përbën kusht për skualifikimin e tij mosparaqitja e mostrave.*

Pra në shqyrtimin e ofertës së BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, nuk është bërë marrja në dorëzim e mostrave dhe më tej as shqyrtimi i tyre për përmbushjen e treguesve teknike të parashikuar në Formularin e Specifikimeve Teknike, si një kriter kualifikues i

konsideruar i nevojshëm nga ana e njësisë së prokurimit për kualifikimin e ofertuesve. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor ka argumentua se: **“Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Pra vetë AK e ka parashikuar kriterin për paraqitjen e mostrave si të rëndësishëm për vlerësimin e aspektit teknik të ofertës, me qëllim që cilesia e mallit të jete në përputhje me kërkesat e përcaktuara, ndërkohë që nuk është bërë e mundur të gjykohej për këtë kapacitet të BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, përderisa mostrat nuk janë paraqitur sipas afateve të paracaktuara në dokumentat e tenderit.

Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurimi. Mostrat - referuar edhe legjislacionit në fuqi-, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni apo mostre dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara, sidomos në rastin konkret që objekt i prokurimit janë artikuj me një specifikë të veçantë dhe mosrespektimi i specifikimeve teknike të kërkuara do të ndikonte në funksionalitetin e tyre. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në lidhje me paraqitjen e mostrave. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues COLOMBO SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “COLOMBO” SHPK, për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë, pasi BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK

nuk përmbush kriteret e kualifikimit, dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshon gjendjen juridike të këtij bashkim operatorësh ekonomikë, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*COLOMBO*” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur -punë*”, me Nr. REF-32450-12-10- 2024, me objekt “*Rikualifikim urban i pallateve në hyrje të Selenicës*”, me fond limit 50,390,955.29 lekë (pesëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë njëzet e nëntë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë, BOE “SARDO” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, referuar konstatimeve në këtë vendim.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*COLOMBO*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

